



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AUTORITETI KOMBËTAR I INVESTIGIMIT PËR SIGURINË E OPERIMIT
NË AVIACIONIN CIVIL

Nr. 59 Prot.

Tiranë, më 27/01/2025

URDHËR

Nr. 2 datë 27/01/2025

PËR NJËSIMIN E DOKUMENTIT ADMINISTRATIV

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 11, pika b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat", dhe VKM-së nr.739 datë 03.12.2021, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil

URDHEROJ:

1. Dokumentet administrative të perpiluara sipas Normave tekniko- profesionale të Republikës së Shqipërisë duhet të jenë në përputhje me modelet bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Siglimi i kopjes së dytë të dokumenteve kryhet si më poshtë:

Konceptoi: Nistore e emrit, pike, mbiemri i plotë, nënshkrimi i konceptuesit.

Pranoi: Nistore e emrit, pikë, mbiemri i plotë, nënshkrimi i përgjegjësit të strukturës së nivelit të parë (nëse ka).

Miratoi: Nistore e emrit, pikë, mbiemri i plotë, nënshkrimi i përgjegjësit të strukturës së nivelit të dytë (nëse ka).

Konfirmoi: Nistore e emrit, pikë, mbiemri i plotë, nënshkrimi i zëvendësuarit, juristit, apo pozitës tjetër të përcaktuar.

3. Dokumentet të perpilohen me shkrim Times New Roman, me madhësi 12 dhe hapësira midis reshtave të jetë 1.15, si dhe në anësore të lihen 3 cm bosh, ndërsa në krye e në fund të faqes nga 2 cm.

4. Dokumentet të perpilohen në bazë të rregullave drejtshkrimore, ku të përdoren germet (ë) dhe (ç), si dhe kryeradhët.

Struktura të shënohet në dokumentet administrative vetëm në nivelin e strukturës me të



lartë (Departamentit ose Drejtorisë, ose Sektorit etj., sipas rastit nese ka) që ka konceptuar dokumentin.

Titullari i institucionit është strukturë me vete, ne rastin e dokumenteve të konceptuara nga ai dhe në këto dokumente shënohet si strukturë më vete emërtesa e titullarit sipas organikës.

6. Perjashtimisht, në rastet kur dokumentet janë produkt i pozicioneve të posaçme të punes, të parashikuara ne ligj dhe qe nuk janë strukturë me vete, pozicionet shënohen poshtë strukturës perkatese, ku ndodhet pozicioni i posaçëm, sipas rastit, Struktura Përgjegjëse për Sinjalizuesit, Autoriteti Përgjegjës për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Koordinatori për të Drejtën e Informimit, Personi pergjegjes i Burimeve Njerezore e të tjera.

7. Njësia e Prokurimeve, Grupi i Menaxhimit Strategjik, grupet ad-hoc të punës, si dhe të gjitha njësitë e tjera të ngritura sipas ligjit specifik ne nivelin më të larte drejtues, shenohen si nënstrukturë, poshtë struktures me emërtesën e titullarit, sipas organikës së institucionit.

8. Sekretari-arkivi i institucionit njofton titullarin ne te gjitha rastet kur shkresat nuk perpilohen sipas këtij urdhri.

9. Ngarkohen strukturat e institucionit, pozicionet e posaçme të punes, sipas ligjit, dhe sekretari-arkivi për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn ne fuqi menjëherë.

DREJTORI I AUTORITETIT

Genc RESULI

